




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR/DORËZUAR: DATE PRILLEN DOSTAVLJEN: DATE RECEIVED/SUBMITTED:			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shit. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
06	47	1792	5



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

769
31.01.20

Plani veprimt për adresimin e të gjeturave nga ZKA
NGA: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

Nr. I rek.	Rekomandimi	Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit	Masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimit.	Periudha e zbatimit të rekomandimit
1	Në koordinim me Zyrën e Kryeministrit të kryejnë veprimet e nevojshme për transferimin e inspektorëve komunal në AUV në harmoni me Ligjin për Ushqim dhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës së inspektorëve duke mbuluar edhe komunat që aktualisht kanë mungesë të inspektorëve.	AUV	Edhe pse AUV viteve të kaluara ka bërë të gjitha përpjekjet për ta mundur transferimin e inspektorëve komunal në kuadër të AUV-së një gjë e tillë nuk është mundur. AUV do të vazhdojë me përpjekjet e mëtejshme për ta mundur këtë veprim. Nga komisioni Evropian është aprovuar edhe projekti i ndërtimit të ndërtesave të zyrave regjionale dhe do të vazhdojë me ndërtimin e tyre për ta mundur vendosjen e inspektorëve edhe komunal	Lidhur me këtë rekomandim mund të themi se përveç sqarimit të masat, kjo çështje nuk, varet nga AUV.

			në këto objekte.	
2	Të sigurojë se procedurat standarde të operimit shpërndahen dhe i komunikohen të gjitha njësive përgjegjëse për zbatimin e tyre.	DSHP, DI	Drejtoria e Shëndetit Publik do të organizoj që të gjitha PSO-të e aprovuara dhe ato të cilat janë në procedurë të aprovimit, të shtypen dhe përgatiten në një përmbledhje e cila do tu shpërndahet të gjitha njësive organizative të AUV-së (Drejtorive, sektorëve dhe zyrave regjionale). Po ashtu, PSO-të do të shpërndahen në formë elektronike dhe gjithsesi të vendosen në sistemin elektronik të AUV-se dhe në web faqen zyrtare .	Përgatitja e një dosje, regjistratori (fajlli) të PSO-ve, manualeve dhe listave kontrolluese ka filluar në janarit e parë të Janarit 2020, shtypja e një përmbledhjeje do të realizohet në fund të muajit shkurt(varësisht nga mundësitë buxhetore) kurse shpërndarja elektronike përmes e-mailit do të filloj javën e dytë të muajit shkurt. Vendosja në web. faqe dhe në sistemin elektronik do të filloj pas konsultimit me ekspertët e IT dhe sipas mundësive to të realizohet gjatë muajit Mars 2020.
3	Të zhvillojë sistemin aktual elektronik në pika inspektuese kufitare që të mundësojë identifikimin e kompanive që kanë rezultat pozitiv të analizës për të siguruar se merret mostra e nevojshme për analizë.	DI Sektori i TI	Zyrtarët e sektori të IT kanë rishikuar sistemin aktual dhe kanë vlerësuar se mundet të avancoj në atë mënyrë që të epet mundësia e krijimit të alertit i cili shihet nga gjithë inspektorët .	Deri në Maj 2020 sistemi do të avancohet.
4	Të ndërmerren veprime në bashkëpunim me komunat për të siguruar mbulimin me kontrolle të të gjithë zinxhirit ushqimor, duke siguruar edhe mbikëqyrjen e tregut të kafshëve dhe të gjelbër në secilën komunë.	DI;	Të gjithë shefave të sektorëve të Drejtorisë së Inspektionit dhe koordinatorëve të zyrave regjionale zyrtarisht iu është kërkuar që në planet individuale të kontroleve zyrtare të inspektorëve të përfshihen edhe inspektionet relevante komunale.	Shkurt 2020
5	Të sigurojë proces efektiv për mostrat e dërguara për analizë me qëllim që rezultatet e analizave të	DI;DSHP	AUV ka sensibilizuar Inspektorët që të lajmërojnë me kohë (brenda afatit)	PSO do të filloj së hartuari

	përdoren në funksion të sigurisë së ushqimit në treg.		<p>mungesën e rezultateve të analizave.</p> <p>Iu është tërhequr vëmendja menaxherëve të kontratave të parashtrajnë ankesë tek menaxhmenti dhe tek laboratorët për vonesat.</p> <p>AUV do të hartoj PSO të veçantë lidhur me menaxhimin e rezultateve të analizave laboratorike.</p>	në muajin Maj.
6	Të vë në funksion sa më shpejt që është e mundur sistemin elektronik për kontrole të brendshme duke shtrirë përdorimin në të gjitha Zyrat Regjionale dhe nga gjithë inspektorët veterinar, fitosanitar dhe sanitar.	Sektori i TI	Projekti donacion i BE-së i cili ka filluar së zbatuari në Qershor 2019 do të krijoj një sistem të unifikuar në të cilën do të ndërliidhen edhe zyrat regjionale sipas bazuar në web platformë (web based platforme)	Përfundon në 2021.
7	Të marrë veprimet e nevojshme për funksionalizimin dhe akreditimin e Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë për zhvillimin e analizave të nevojshme për produkte të cilat aktualisht kryhen në institute tjera apo jashtë vendit.	LUV	<p>LUV është i akredituar me standardin ISO 17025: 2005 qysh nga viti 2014.</p> <p>Akreditimi i metodave testuese në produkte të ndryshme bëhet varësisht nga nevojat , sasia dhe kostoja e zhvillimit të tyre.</p> <p>Analizat të cilat realizohen në laboratorë tjera, është rezultat i kalkulimit të kostos se a e vlejné për një numër të caktuar të mostrave të zhvillohen metodat e ndryshme.</p> <p>Megjithatë, LUV i ka në procedurë 5 metoda të reja për ti akredituar të cilat janë kosto-efektive dhe mundësojnë realizimin e analizave në LUV.</p>	Akreditimi i 5 metodave do të varet edhe nga vijueshmëria e procedurave të prokurimit të cilat pritet të përfundojnë deri në Qërshorë 2020.

8	Të krijohet bazë të plotë me të dhëna për bizneset që ofrojnë ushqim me prejardhje bimore dhe shtazore. Kjo duhet të shërbejë për planin vjetor nacional për të siguruar se e gjithë industria ushqimore mbulohet me kontrolle.	DSHP;DI	Me projektin nga rekomandimi 6 , të gjitha bizneset ushqimore do të regjistrohen automatikisht nga ARBK në sistemin elektronik të AUV-së. Ndërkohë, AUV do të vazhdojë me sistemin aktual të përfshirjes së operatorëve në listat aktuale dhe kontrollet sipas planit.	Deri në qershor 2021 i tërë sistemi do të jetë funksional.
9	Të hartohet procedura për secilin sektor duke siguruar që kontrollet zyrtare kryhen me metoda adekuate nga të gjithë inspektorët.	DSHP,DI	Hartimi i procedurave standarde të operimit është aktivitet në vazhdimësi. Deri më tash, janë 5 PSO të sektorit fitosanitar të hartuara dhe në pritje të adoptimit të akteve relevante për të vazhduar me zbatim.	Sipas planit legjislativ , aktet ligjore në të cilat thirren këto PSO duhet aprovuar nga MBPZHR deri në fund të vitit 2020
10	Të sigurojë monitorim të rregullt dhe efektiv për të gjithë sektorët e kontrolleve të brendshme dhe kufitar/pika inspektuese kufitare.	DSHP	Monitorimi i realizimit të planit të kontrolleve zyrtare nga inspektorët do të realizohet dy herë në vit nga sektorët e DSHP-së.	Monitorimi do të realizohet në fund të tremujorit të dytë dhe në fund të vitit.(Korrik dhe Dhjetorë)
11	Të sigurojë që listat kontrolluese janë në pajtim me parimet e HACCP-it dhe kërkesat e parapara në legjislation.	DSHP,DI	Gjatë javës së tretë të Janarit përmes JICA-së (donator Japonez) është mbajtur trajnimi i 13 inspektorëve sanitarë dhe veterinarë lidhur me parimet e HACCP-së me çast janë draftuar edhe pyetësorë të veçante me theks të veçante për parimet e HACCP-së.	Pyetësorët e rinj do të rishikohen nga DSHP gjatë muajit shkurt dhe aprovohen për përdorim.
12	Të trajnojë stafin lidhur me plotësimin e Listave Kontrolluese në mënyrë që të ofrohet një informacion i saktë për gjendjen në teren. Po ashtu, DSHP duhet të rifreskojë kategorizimin e kompanive sipas informacioneve që kanë Zyrat Regjionale, në kohë reale.	DSHP	Plani Kombëtarë vjetorë i kontrolleve zyrtare 2020 do të shpërndahet inspektorëve të AUV-së dhe trajnimi për realizimin e tij do të mbahet paralelisht me të. Rifreskimi i kategorive nga DSHP do të përbushet pas marrjes së informatave nga kontrollet e realizuara në tremujorin e parë të vitit.	Trajnimi në shkurt 2020 Rifreskimi pas tremujorit të parë (prill)

13	Të sigurojë që kontrollet në pika inspektuese kufitare kryhen sipas procedurës standarde të operimit për marrjen e mostrave përfaqësuese për të siguruar që produktet e importuara i plotësojnë kushtet për konsum.	DI	Edhe pse pas vërejtjeve në raportin final, inspektorëve kufitarë iu janë komunikuar të gjeturat dhe dhënë instruksionet për zbatimin e PSO-ve, AUV do të organizojë trajnime të veçanta për marrjen e mostrave.	Trajnimet me të gjithë inspektorët kufitarë do të organizohen në periudhën Maj-Qershor 2020
14	Të sigurojë që të gjitha produktet në treg përmbajnë përshkrime adekuate të përmbajtës së tyre duke mundësuar që konsumatorët të kenë njohuri se çfarë ushqimi konsumojnë.	DI	Inspektorët e AUV-së do të vazhdojnë me kontrollet e etiketimit dhe deklarimit të produkteve. Për më shumë, në Dhjetorë 2019 janë ndërmarrë takime me operatorët e ushqimit lidhur me etiketimin e produkteve. Si rrjedhojë është iniciuar krijimi i shoqatës së përpunuesve të mishit dhe takimet do të vazhdojnë edhe gjatë muajit shkurt. Megjithatë, frekuenca e kontrolleve të tregut lidhur me etiketimin dhe autenticitetin e produkteve do të rritet.	Takimet me shoqatat gjatë muajit shkurt. Frekuenca e kontrolleve nga fillimi i shkurtit 2020.